



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr.5

Prishtinë, më 06.02.2015, ora:13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-II

Procesverbal

i mbledhjes së komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti, Sadri Ferati, Xhevahire Izmaqi, Alma Lama, Shqipe Pantina,

Mungoi: Zafir Berisha, Kujtim Paçaku, Jelena Bontic dhe Pal Lekaj.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Në mbledhje morën pjesë përfaqësuesit e shoqërisë civile: INDEP, KDI, GAP, IPZHK, CPT, D4D, AKK, OSCE, ZPRK.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje është propozuar ky rend dite:

1. Takimi i komisionit me organizatat e shoqërisë civile.

Mbledhjen e kryesoi kryetari i komisionit,

Zenun Pajaziti - i njoftoi organizatat e shoqërisë civile se qëllimi i takimit ishte njohimi i këtyre organizatave me planin e punës së komisionit, prezantimi i punës së komisionit në drejtim të një bashkëpunimi sa më të mirë me shoqërinë civile si dhe mbështetja e komisionit nga këto organizata për ato çështje që bien në fushëveprimtarinë e komisionit, mbi bazë të Deklaratës së Kuvendit për partneritet me shoqërinë civile Ai, gjithashtu i njoftoi këto organizata për mbështetjen që komisioni ka pasur nga: OSCE, KDI, INDEP. Hapi debatin.

Driton Selmanaj – KDI - e njoftoi komisionin se për një projekt dy vjeçar në mbështetje të USAID-it për ofrimin e hulumtimeve të legjislativit, praktika për funksionimin e projektit do të jetë nëpërmjet drejtorisë për hulumtime pranë Kuvendit të Kosovës, në mënyrë që pastaj KDI kontraktonte ekspert, KDI, inkurajon komisionin për shfrytëzimin e mundësisë së ofruar.

KDI, gjithashtu njoftoi për një program të veçantë për qeverisje lokale, i cili ekskluzivisht është përqendruar për regjionin e Prizrenit, kërkesa e KDI ishte organizimi i dëgjimeve publike në procedurat e shqyrtimit të projektligjeve.

Arben Ahmeti - D4D- përfaqësuesi i saj, tha se ata janë një institut që ka për qëllim koordinimin e organizatave dhe grupeve të interesit dhe vendosja e dialogut në mes tyre.

Dardan Abazi - INDEP- tha se gatishmëria e komisionit për organizimin e takimeve me shoqërinë civile reflekton se do të jetë një bashkëpunim i mirë, INDEP për tri vite publikon raportin “Gjendja e mediave në Kosovë”, të cilin raport e publikon në ditën e lirisë së mediave.

Shqipe Arifaj – Asociacioni i komunave të Kosovës - njoftoi komisionin se asociacioni i komunave është organizatë në të cilën përfaqësues janë kryetarët e komunave dhe si organizatë mbulon fushën e qeverisjes lokale.

Alma Lama – përkrahu projektin e KDI-së, ndërsa nga INDEP kërkoi që të hartojnë një raport të veçantë për gratë në media, d.m.th raport për prezantimin e grave në media, në edicionet dhe debatet informative, në televizionet kombëtare.

Shqipe Pantina – ajo tha, meqë disa OJQ kanë shtrirje jashtë Prishtinës, të krijohen mundësitë për organizimin e takimeve, dëgjimeve publike me ato OJQ, që edhe të ngritet pjesëmarrja e tyre si dhe ngritja e debateve për çështjet të cilat jo domosdoshmërisht janë diskutuar në Kuvend duke i dhënë prioritet administratës publike dhe vetëqeverisjes lokale.

Xhevahire Izmaqu - duke përkrahur propozimet dhe kërkesat e anëtarëve të komisionit, si të qëlluara, ajo kërkoi nga organizatat e shoqërisë civile që lidhur me digjitalizimin ato ti sjellin praktikën e vendeve që kanë karakteristika të njëjta si regjion si dhe rreth agjencioneve dhe bordeve të pavarura, si mund të krijohet një trup e veçantë brenda Kuvendit që do të merrej me punën e agjencioneve të pavarura të cilat emërohen nga Kuvendi.

Përfaqësuesit e Institutit GAP- u deklaruan për mbështetjen e tyre për çështjet e organizimit të administratës publike, administratës shtetërore, shërbimin civil, për P/ligjin për kufijtë administrativ të komunave, si dhe P/ligjin për pagat e funksionarëve të lartë publik.

Slavko Trajkovic- Qendra për paqe dhe tolerancë në Graçanicë - duke njoftuar komisionin për projektin e tyre të mbështetur nga USAID “të përparojmë Kosovën së bashku”, ai tha se kjo organizatë nuk mund të mbështet komisionin për çështjet të cilat u diskutuan, por mund të mbështesin në rregullimin e komunikimit jashtë qendrës, kjo do të thotë komunikimin në mes nivelit qendror dhe lokal, në mënyrë që komisioni të informohet me nevojat dhe kërkesat konkrete të komunave të reja dhe komunave me shumicë serbe, gjatë procedurave të plotësimit ndryshimit të ligjeve.

Mbledhja përfundoi në ora: 14:00.

Përgatitur nga :

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

**Kryetari i Komisionit
Zenun Pajaziti**
